



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 07.07.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 02.07.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “**Bajra N.P.T.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Furnizim me Motokultivator te vegjël, motokultivator te mëdhenj, plugje, freza dhe mbjellëse misri , me Nr. të Prok:632-21-3669-1-2-1, Nr. Brendshëm : 632-21-053-1-2-1, nxjerr:**

V E N D I M

- I. **Aprovohet** si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim Operatori Ekonomik “**Bajra N.P.T.** e dt.02.07.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizim me Motokultivator te vegjël, motokultivator te mëdhenj, plugje, freza dhe mbjellëse misri , me Nr. të Prok:632-21-3669-1-2-1, Nr. Brendshëm : 632-21-053-1-2-1, kundër Dosjes së tenderit, te AK –së, të datës 17.06.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .**
2. Përmirësohet **DOSJA E TENDERIT E AUTORITETIT KONTRAKTUES** e publikuar me datë: **17.06.2021;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëj përmisimin e Dosjes tenderit-specificimit teknik.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Meqë Operatori Ekonomik “**Bajra N.P.T.**, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizim me Motokultivator te vegjël, motokultivator te mëdhenj,**

plugje, freza dhe mbjellëse misri , me Nr. të Prok:632-21-3669-1-2-1, Nr. Brendshëm : 632-21-053-1-2-1,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 07.07.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas rishikimit te dosjes tenderit Autoriteti kontraktues sqaron se: pretendimi i Operatorit Ekonomik “**Bajra** “**N.P.T** është pjesërisht i bazuar dhe Autoriteti kontraktues do të bëj përmirësimin e Dosjes tenderit-specifikimit teknik;

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur që të bëj përmirësimin e Dosjes tenderit-specifikimit teknik.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara
Arkivit të Komunës


z. Faton Gutaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit